



UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I HISTORISË DHE FILOLOGJISË
DEPARTAMENTI I ARKEOLOGJISË DHE TRASHËGIMISE KULTURORE

PROGRAMI I LËNDËS
Drejtimi : Arkeologji dhe Trashëgimi Kulturore

TITULLI I LËNDËS: ARKEOLOGJIA E ANTIKITETIT TË VONË DHE MESJETËS

Pedagogu: Dr. Elio Hobdari
Ngarkesa: 4 ECTS (30 leksione dhe 15 seminare)
Lloji i lëndës: Lëndë me zgjedhje
Programi i studimit: Bachelor
Viti/Semestri: III/I

EKSTRAKT

Lënda synon që të njohë studentët me karakteristikat e përgjithshme të periudhës (Antikiteti i vonë dhe mesjetë) në këndvështrim arkeologjik. Në mënyrë të veçantë do të përqendrohet në situatën e kërkimeve në territorin e Shqipërisë duke u plotësuar me informacion për kryeqytetin (Kostandinopojën) dhe disa provinca të tjera. Do të trajtohen historiku i kërkimeve në vend, problemet që dalin dhe kontributi që sjell arkeologjia e antikitetit të vonë dhe të mesjetës në përgjithësi për shkencën arkeologjike shqiptare dhe për historinë e Shqipërisë. Do të njihen studentët me gërmimet më të spikatura të kohëve të fundit për këtë periudhë. Studentët do të njihen me materialin arkeologjik që sjellin këto monumente, informacionin që jep dhe mënyrën e trajtimit të tij. Do të diskutohen drejtimit, në të cilat do të duhet të ecin kërkimet në këtë fushë në të ardhmen.

TEMAT:

LEKSION 1. Problemet e arkeologjisë së antikitetit të vonë dhe mesjetës: Vendi që zë arkeologjia bizantine në kërkimet arkeologjike shqiptare, historiku i kërkimeve. Problemet e ndeshura dhe të zgjidhura. Detyra për të ardhmen.

LEKSION 2. Problemet e arkeologjisë së antikitetit të vonë dhe mesjetës (pjesa II)

LEKSION 3. Qytetet në Antikitetin e Vonë:

Fortifikimet antikitetit të vonë, vazhdimësia dhe tiparet e fortifikimeve të reja. Tipet e qendrave të fortifikuara, malore kodrinore, karakteristikat e arkitekturës së fortifikimeve, teknikat dhe materiali i ndërtimit, kulla, porta, kurtina, akropol, *diatechisma*.

LEKSION 4. Qytetet në Antikitetin e Vonë (pjesa II): Transformimi urban, prishja e hapësirës publike, marrëdhëniet ekonomike nën dritën e kërkimeve arkeologjike. Prishja e sistemit urbanistik të antikitetit, okupimi i hapësirës publike, pakësimi i ndërtimeve publike, karakteristikat e banesave të antikitetit të vonë, punishtet, rrugët, akuaduktet, varrimet në hapësirën urbane.

LEKSION 5. Organizimi administrativ dhe kishtar në Antikitetin e Vonë.

LEKSION 6. Ndërtimet e kultit kristian (kishat paleokristiane). Kishat paleokristiane, arkitektura, tipet e ndryshme, kishat urbane, kishat peshkopale katedrale, kishat e pelegrinazhit, komplekset kishtarë, kishat ekstraurbane. Pozicioni në rrjetin urban. Pjesët përbërëse të kishave, naosi, narteksi, anekset, atriumi, baptisteri. Teknikat e ndërtimit dhe dekoracioni i interierit, piktura dhe mozaiku parietal, dyshemetë me pllaka, mozaik, tulla etj, skulptura arkitektonike, tiparet zonale të kishave në bazë të teknikave të ndërtimit dhe dekoracionit. Instalimet në funksion të liturgjisë, pjesët përbërëse dhe prodhimi i tyre, importet dhe prodhimi lokal. Fenomeni i *spolia-ve*, tipet e ndryshme. Fenomeni si komponent i ekonomisë së periudhës. Pasqyrimi në legjislacionin perandorak. Ambientet ekonomike në komplekset kishtarë, të dhënat arkeologjike

LEKSION 7. Ndërtimet e kultit kristian (kishat paleokristiane). Pjesa II.

LEKSION 8. Kultura materiale në antikitetin e vonë. Qeramika, prodhimi dhe tregtimi, metalet, qelqi. Numizmatika.

LEKSION 9. Nekroplet, Kultura e Komanit. Tipat e ndryshme të varrimeve në antikitetin e vonë, karakteristikat kristiane të varrimeve. Varrezat e “Kulturës së Komanit”, shpërndarja, tipet e varrimeve, kultura materiale e varreve, datimi.

LEKSION 10. Organizimi administrativ në periudhën e mesme e të vonë bizantine.

LEKSION 11. Qyteti bizantin: Transformimi i qytetit, krahasimi me antikitetin e vonë. Ndryshimet e qytetit, organizimi i tij, fortifikimi, ndërtimet e kultit në qytet, krahasimi me kishat jashtë qyteteve dhe manastiret. Ekonomia në mesjetë e reflektuar në kërkimet arkeologjike. Sistemi rrugor, banesat, ujësjellësit (Melan).

LEKSION 12. Qyteti bizantin: Kishat mesjetare.

Ndërtimet e kultit në qytet, krahasimi me kishat jashtë qyteteve dhe manastiret. Tipet e kishave në mesjetë, kishat e thjeshta me një nef, bazilikat, kishat në formë kryqi, përdorimi i kupolave. Dekoracioni i kishave, teknikat e ndërtimit, përdorimi i kluasonazhit dhe dekoracioneve të ndryshme të qeramikës, Berati, Labova e Kryqit, Peshkëpia e Sipërme (GJ), Boboshtica, Ballshi etj, ripërdorimi i materialit më të hershëm antik: Kurjan, Apoloni, Shën Jan, Mesopotam etj. Instalimet liturgjike dhe skulptura arkitektonike.

LEKSION 13. Kishat mesjetare. Pjesa II.

LEKSION 14. Kultura materiale dhe monedhat.

Qeramika, qelqi, metalet, bizhuteritë, prodhimi dhe tregtia. Fenomeni i *spolia-ve*, ndikimi në pikëpamje teknike dhe aspekti ekonomik i tij. Numizmatika.

LEKSION 15. Arkeologjia pasbizantine dhe otomane

Eksperienca shqiptare në kërkimet në Kaninë, Berat, Elbasan, Voskopojë, Apoloni, Xhermëhallë (DL) etj.

FORMA E KONTROLLIT DHE VLERËSIMIT

FREKUENTIMI:

70% pranisë në seminare e domosdoshme.

15 % e notës përfundimtare nga prania dhe angazhimi gjatë kursit apo seminareve

KONTROLLI I VAZHDUESHËM:

Testi 1 i pjesshëm në javën e 6-të (10% e notës përfundimtare)

Testi 2 i pjesshëm në javën e 10-të (15% e notës përfundimtare)

25 % e notës përfundimtare.

DETYRA E KURSIT:

Detyrë kursi ose konspekt i një teksti apo autori ose ese nga 3-5 faqe format A4, Times New Roman, madhësia e shkrimit 12, hapësira mes rreshtave 1.5)

20 % e notës përfundimtare

KONTROLLI PËRFUNDIMTAR:

Një test përfundimtar në javën e 16-të të kursit pas kryerjes së 15 javëve të një semestri

40 % e notës përfundimtare

DETYRIMET E STUDENËVE PËR LËNDËN

Frekuentim i rregullt në leksione.

Frekuentim i detyruar në të paktën 70% të seminareve të lëndës.

Përgatitja e një ese-je nga 3-5 faqe format A4, Times New Roman, madhësia e shkrimit 12, hapësira mes rreshtave 1.5.

Pjesëmarrje në testet e pjesshme gjatë semestrit.

Testi (provimi) përfundimtar (i fundit të smestrit)

LITERATURA:

S. ANAMALI, Amantia, *Iliria* II, 1972, f. 61-133. S. ANAMALI, Mozaikët e bazilikës paleokristiane të Linit (PG), *Iliria* III, 1974, f. 329-342.

S. ANAMALI, Bazilika e Ballshit, *Iliria* VII-VIII, 1977-1978, f. 301-306.

ANAMALI, S., Keshtjella e Pogradecit (*The castle of Pogradec*), "Iliria", IX – X, 1979 – 1980, f. 211 – 258, 19 tab. Res.fr.

S. ANAMALI, Rreth skulpturës dekorative arkitektonike të bazilikës së Ballshit, *Iliria* 2, 1981, f.237-242.

S. ANAMALI, Architettura e decorazione tardoantica in Albania. *XL Corso di cultura sull'arte ravennate e bizantina*, Ravenna, 1993, f. 447-474.

BACE, AA., Qyteti i fortifikuar i Kanines (*Fotified city of Kanina*), "Monumentet" 7 – 8, 1974, f. 25 – 54, 26 fig., 5 tab. Rés.fr.

A. Baçe, A. Meksi, E. Riza, Gj. Karaiskaj, P. Thomo, *Historia e arkitekturës shqiptare* (Nga fillimet deri në v. 1912) (maket), Tiranë, 1980.

A. Baçe, Fortifikimet e antikitetit të vonë në Shqipëri, *Monumentet*, 11, 1976.

BAÇE², Apollon, - KARAIKAJ¹, Gjerak, Kalaja e Durrësit dhe fortifikimet përreth në kohën e vonë antike. (La forteresse de Durrës et les autres fortifications environantes pedant la Basse l'Antiquite), *"Monumentet"*, 9, 1975, f. 5-33, me 31 fig., dhe 3 tab. Rés. fr.